



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 98/2 Prot

Tiranë, më 07.04.2021

V E N D I M

Nr. 34, datë 07.04.2021

Mbi vlerësimin e ligjshmërisë së disa procedurave të pranimit në shërbimin civil në Bashkinë Gjirokastrë dhe evidentimin e mangësive të konstatuara në disa raste të transferimeve të përkohshme në këtë bashki, duke përcaktuar edhe veprimet që duhet të kryhen për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit dhe materialit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të informacionit të marrë nga drejtuesi i Bashkisë Gjirokastrë,

VËREJ SE:

Nëpërmjet shkresës së rregjistruar me nr. 781, datë 12.10.2020 “Kërkesë për inspektimin e procedurave në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil”, paraqitur pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, drejtuesi i Bashkisë Gjirokastrë ka parashtruar kërkesën për vlerësim të ligjshmërisë për disa procedura të pranimit në shërbimin civil dhe transferimeve të përkohshme në detyrë, për nevoja të institucionit, të disa nëpunësve në këtë bashki.

Konkretisht, është kërkuar një inspektim, për vlerësim nga pikëpamja ligjore, të një kategorie veprimesh administrative, të kryera në institucionin e Bashkisë Gjirokastrë, në lidhje me procedurat e ndjekura deri më sot në implementimin e disa prej instituteve të ligjit për shërbimin civil, si: në rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë,

transferimet e përhershme e të përkohshme, si dhe respektimin e kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës.

Nisur nga natyra e kërkesës së paraqitur nga ana e drejtuesit të institucionit dhe problematikat e ngritura në të, materiali u grupua në dy pjesë:

a) në procedura për pranimin në shërbimin civil, sipas detyrave të lëna nëpërmjet një vendimi të mëparshëm të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *(është fjala për Vendimin nr. 11, datë 09.03.2018 “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Gjirokastrë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”)*;

b) raste të ndryshme të ekstratuara nga praktika e paraqitur, të cilat në vetvete përbënin mosrespektim të procedurave ligjore, të kërkuara nga legjislacioni i shërbimit civil, në rastet e transferimeve të përkohshme, për nevoja të institucionit, lëvizje paralele, etj.

Gjithë materiali që përmbanin këto raste, është analizuar dhe sistemuar në mënyrë analitike, e mbi këtë bazë u bënë dhe konkluzionet përmbledhëse, të përbashkëta për secilin grup çështjesh që kishin karakteristika të njëjta dhe analizë të detajuar për ato gjetje, që u konsideruan të zgjidhura në kundërshtim me rregullat e administrimit të shërbimit civil, duke **(i)** evidentuar parregullsitë; **(ii)** duke përcaktuar mënyrën si duhej trajtuar rasti, shoqëruar edhe me **(iii)** masat që duheshin marrë në mënyrë të menjëhershme, për secilin prej tyre, për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë.

Gjithë këto raste, siç u tha dhe më lart, janë analizuar me hollësi në vijim, duke evidentuar si rastet kur janë zbatuar drejt kërkesat e ligjit, ashtu dhe rastet e kundërta, për të cilat janë parashtruar rrethanat konkrete që nuk janë marrë parasysh në trajtimin e tyre dhe rrugët që duhen ndjekur për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë.

Konkretisht, parashtrojmë sa më poshtë:

Së pari, konstatohet fakti që nga ana e njësisë përgjegjëse, është kryer një punë e mirë në drejtim të zbatimit të detyrave të lëna nga Komisioneri nëpërmjet vendimit nr. 11, datë 09.03.2018 *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Gjirokastrë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*, për plotësimin e pozicioneve të lira të punës në bashki, duke kryer një sërë procedurash për pranimin në shërbimin civil.

Nisur nga dokumentacioni i dërguar pranë Komisionerit, protokolluar me nr. 301 prot., datë 03.12.2020, u konstatua se janë kryer 21 procedura konkurrimi, të cilat kanë përfunduar me sukses, duke nxjerrë aktet përkatëse të emërimit dhe lidhjen e marrëdhënieve financiare për çdo rast.

Një procedurë konkurrimi që vlen të analizohet në mënyrë të veçantë, duke qenë se është procedura e parë për pranim në shërbimin civil në zbatim të vendimit nr. 11, datë 09.03.2018 të Komisionerit, kryer për nëpunësin më të lartë civil të institucionit, është ajo për plotësimin e pozicionit të punës “Sekretar i Përgjithshëm” në Bashkinë Gjirokastrë. Konstatohet se, pas zhvillimit pa fitues të procedurës së konkurrimit me lëvizje paralele dhe asaj për ngritje në detyrë, është vijuar me procedurën e konkurrimit për pranim nga jashtë shërbimit civil, e cila është finalizuar me aktin nr. 987 prot, datë 04.02.2020, të Njesisë së Burimeve Njerëzore, nëpërmjet të cilit është emëruar “Sekretar i Përgjithshëm në Bashkinë Gjirokastrë” punonjësi *****.

Ky konkurrim është kryer nëpërmjet procedurës së pranimit të hapur në shërbimin civil, të parashikuar në nenin 32, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në vendimin nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND”.

Nga analiza e akteve që materializojnë këtë procedurë, rezulton se, duke u nisur nga fakti që faza e parë e procedurës së pranimit në kategorinë e nëpunësve civilë të lartë drejtues, për pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm” në Bashkinë Gjirokastrë, është mbyllur pa asnjë konkurrent, ka vijuar procesi duke hapur procedurën e pranimit në shërbimin civil për pozicionin e lartë drejtues nga jashtë.

Kështu, në analizë të përcaktimeve ligjore për pranimin e nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese në njësitë e qeverisjes vendore, në nenin 32 “Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përcaktohet ndër të tjera se, përjashtimisht, procedura e pranimit, mund të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori, por në asnjë rast ky numër nuk mund të jetë më shumë se 15% e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kategorisë së lartë drejtuese në institucion.

Nga këqyrja e strukturës organizative të Bashkisë Gjirokastrë, rezulton se pozicioni “Sekretar i Përgjithshëm” është i vetmi pozicion i nivelit të lartë drejtues në institucion dhe për rrjedhë mundësitë për zbatimin e këtij rasti përjashtimor që parashikon rekrutimin nga jashtë shërbimit civil, janë të vogla.

Në këtë rast, njësia e burimeve njerëzore, nisur nga fakti se pozicionet e nivelit drejtues janë të pakta në Bashkinë Gjirokastrë, e ka llogaritur përqindjen ligjore për rekrutim nga jashtë shërbimit civil, duke bashkuar pozicionet e nivelit të lartë drejtues me ato të nivelit të mesëm drejtues të cilat ishin të lira në atë moment, (Drejtor i njesisë së burimeve njerëzore; Drejtor i zhvillimit të bujqësisë dhe pyjeve; Drejtor i drejtorisë së të ardhurave dhe pronave

publike; Drejtor i turizmit, biznesit dhe integritit) dhe në këtë mënyrë ka justifikuar kryerjen e konkurrencimit për pranimin nga jashtë shërbimit civil të Sekretarit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Njësisë së Burimeve Njerëzore, të kësaj bashkie. Nisur nga këto rrethana, arrijmë në përfundimin se në këtë rast është vepruar drejt, në kushtet kur institucionet e administratës vendore të kategorisë së dytë dhe të tretë, ndodhen në pamundësi objektive që ta aplikojnë këtë aspekt të lejuar me ligj.

Ndërkaq, gjatë kryerjes së inspektimit pati një zhvillim të ri: nëpunësi *****, me aktin nr. 959 dt. 27.01.2021, ka paraqitur kërkesën për dorëheqje në bazë të nenit 64, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, kërkesë e cila është miratuar menjëherë nga njësia përgjegjëse, me vendimin nr. 07, datë 27.01.2021.

Duke shqyrtuar përmbajtjen e aktit të miratimit të dorëheqjes, konstatojmë se në të nuk është shënuar e drejta që buron nga pika 4, e nenit 64, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, sipas së cilës “Nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil si pasojë e dorëheqjes, kanë të drejtë të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 e 26 të këtij ligji, deri në dy vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil”, prandaj do të ishte me vend që akti në fjalë të përmbante këtë të drejtë, në mënyrë të shprehur.

Megjithatë, gjatë ushtrimit të kompetencës për menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit, njësia përgjegjëse ka bashkëvepruar dhe bashkërenduar punët e saj me njësitë e tjera pjesë të strukturës së institucionit, me qëllim sigurimin e zbatimit të parimeve të sanksionuara në legjislacionin e shërbimit civil dhe të respektohen procedurat ligjore për çdo institut të tij. Ky fakt konstatohet në gjithë procedurat për emërimin në detyrë të nëpunësve si më poshtë:

1. *****, pas procedurës së konkurrencimit për pranim nga jashtë, me aktin nr. 6940 prot, datë 19.08.2020, të Njësisë së Burimeve Njerëzore, është emëruar “Drejtor në Njësinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Gjirokastrë”.
2. *****, pas procedurës së konkurrencimit, me aktin nr. 7158 prot., datë 25.08.2020, të Njësisë së Burimeve Njerëzore, është emëruar “Specialiste IT” (nëpunës civil në periudhë prove).
3. *****, pas procedurës së konkurrencimit, me aktin nr. 7057 prot., datë 24.08.2020 të burimeve njerëzore, është emëruar “Inspektor për Kontrollin në Terren dhe Ndjekjen e Debitorëve në qytet në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave” (nëpunës civil në periudhë prove).
4. *****, pas procedurës së konkurrencimit, me aktin nr. 6697 prot., datë 12.08.2020, të Njësisë të Burimeve Njerëzore, është emëruar “Specialist i Administrimit të

Pronave Publike në Sektorin e Lejeve dhe Licencave dhe Administrimit të Pronave Publike në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, lejeve dhe Licencave” (nëpunës civil në periudhë prove).

5. *****₁, pas procedurës së konkurrimit, me aktin 7056 Prot., datë 24.08.2020, të Njesisë së Burimeve Njerëzore, është emëruar “*Inspektor për Kontrollin në Terren dhe Ndjekjen e Debitorëve në qytet në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave*” (nëpunës civil në periudhë prove).
6. *****₂, pas procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 9820, datë 26.10.2020 të Njesisë së Burimeve Njerëzore, është emëruar “*Inspektor për vjelje taksash për Njësitë administrative dhe ndjekjen e debitorëve në qytet në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave*” (nëpunës civil në periudhë prove).
7. ***** pas procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 9807, datë 26.10.2020, të Njesisë së Burimeve Njerëzore, është emëruar “*Inspektor për Kontrollin në Terren dhe Ndjekjen e Debitorëve në qytet në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave* (nëpunës civil në periudhë prove).
8. *****₃, pas procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 9886 prot., datë 27/10/2020, të Njesisë së Burimeve Njerëzore, është emëruar “*Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve Publike në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve Publike, në Bashkinë Gjirokastër*” (nëpunës civil në periudhë provë).
9. *****₄, pas procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 8833 prot, datë 05.10.2020, të Njesisë së Burimeve Njerëzore, është emëruar “*Përgjegjës i Sektorit të Koordinimit të Integritit European dhe Ndihmës së Huaj në Drejtorinë e Turizmit, Biznesit dhe Integritit në Bashkinë Gjirokastër*” (nëpunës civil në periudhë prove).
10. ***** pas procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 8808 prot, datë 05/10/2020, të Njesisë së Burimeve Njerëzore, është emëruar “*Përgjegjës i Sektorit të Zbatimit të Buxhetit dhe Raportimit Financiar në Drejtorinë e Financave, në Bashkinë Gjirokastër* (nëpunës civil në periudhë prove).
11. ***** pas procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 7134 prot, datë 25/08/2020, të Njesisë së Burimeve Njerëzore, është emëruar “*Përgjegjëse e Sektorit të Analizës dhe Monitorimit të Performance Buxhetore në Drejtorinë e Financës në Bashkinë Gjirokastër*” (nëpunëse civile në periudhë prove).
12. ***** pas procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 7052 prot, datë 24/08/2020, të Njesisë së Burimeve Njerëzore, është emëruar “*Inspektor për Vjelje Taksash për Njësitë Administrative dhe Ndjekjen e Debitorëve në qytet në Drejtorinë e të*

Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Gjirokastrë (nëpunës civil në periudhë prove).

13. *****, pas procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 7054 prot, datë 24/08/2020 të Njesisë të Burimeve Njerëzore, është emëruar “*Inspektor për Kontrollin në Terren dhe Ndjekjen e debitorëve në qytet në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Gjirokastrë*” (nëpunës civil në periudhë prove).
14. *****, pas procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 7053 prot, datë 24/08/2020, të Njesisë se Burimeve Njerëzore, është emëruar “*Inspektor për Kontrollin në Terren dhe Ndjekjen e debitorëve në qytet në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Gjirokastrë*”, (nëpunës civil në periudhë prove).
15. *****, pas procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 7055 prot, datë 24.08.2020, të Njesisë së Burimeve Njerëzore, është emëruar “*Inspektor për Kontrollin në Terren dhe Ndjekjen e debitorëve në qytet në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Gjirokastrë*” (nëpunës civil në periudhë prove).
16. *****, pas procedurës së konkurrimit emëruar me aktin nr. 9936 prot, datë 17.12.2019, të Njesisë së Burimeve Njerëzore, është emëruar “*Specialist Prokurimesh në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve në Bashkinë Gjirokastrë, (nëpunës civil në periudhë prove).*
17. *****, pas procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 6872, datë 18.09.2019, të Njesisë së Burimeve Njerëzore, është emëruar “*Specialist Auditi në Bashkinë Gjirokastrë*” (nëpunës civil në periudhë prove).
18. *****, pas procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 7058 prot, datë 24/08/2020 të Njesisë së Burimeve Njerëzore, është emëruar “*Inspektor për Kontrollin në Terren dhe Ndjekjen e Debitorëve në qytet në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Gjirokastrë*” (nëpunës civil në periudhë prove).
19. *****, pas procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 7051, datë 24.08.2020, të Njesisë së Burimeve Njerëzore, është emëruar “*Inspektor për vjelje taksash për Njësitë Administrative dhe ndjekjen e debitorëve në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Gjirokastrë*” (nëpunës civil në periudhë prove).
20. *****, pas procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 9938, datë 17.12.2019, të Njesisë së Burimeve Njerëzore, është emëruar “*Specialist për Kontrollin e Konstruksioneve në Sektorin e Projekteve në Bashkinë Gjirokastrë*” (nëpunës civil në periudhë prove).

Nga dokumentacioni i administruar gjatë procesit të hetimit, rezultoi se në përmbajtjen e aspekteve më të rëndësishme të konkurrimeve të mësipërme si, shpallja e pozicionit të lirë, njoftimi në faqen e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, ngritja e Komitetit të Përhershëm të Pranimit, respektimi i rregullave të kryerjes së fazave të konkurrimit, aktet e emërimit, etj., janë kryer në përputhje me rregullat e legjislacionit të shërbimit civil. Megjithatë, duhet të theksohet që, pavarësisht se proceset e konkurrimit dhe rezultatet e arritura, kanë qenë të ligjshme, nga ana e njësisë së burimeve njerëzore, që është njësia përgjegjëse për hartimin e dokumentacionit dhe ndjekjen e procesit, duhet të tregohet më shumë kujdes në formulimin e akteve, sidomos në bazën ligjore dhe emërtimin e saktë të fazave të procesit të konkurrimit, pasi në mjaft prej tyre, ka referenca të vendimeve të mëparshme të Këshillit të Ministrave, të cilët janë shfuqizuar dhe ndryshuar. Krijojmë bindjen se kjo ka ardhur si pasojë e përdorimit të modeleve të gatshme, të mëparshme, të memorizuara në kompjuter dhe nuk është treguar vëmendja e duhur për azhurnimin e tyre me legjislacionin në fuqi.

Kjo është një detyrë për njësinë përgjegjëse, e cila duhet të tregojë kujdesin e duhur që të mos përsëritet në të ardhmen.

Së dyti, një aspekt tjetër i mënyrës së menaxhimit të burimeve njerëzore, që lidhet drejtpërdrejtë me plotësimin e objektivave dhe detyrave të përditshme të institucionit, si dhe me zhvillimin e një marrëdhënie korrekte në shërbimin civil, që u evidentua si grup problemor e që kërkoi një vëmendje të vecantë, është ***kryerja e transferimeve të përhershme apo të përkohshme***, në interes të punës dhe institucionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenet 48 e 50, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Sipas dispozitave të mësipërme, kërkohen disa kushte që një transferim i përhershëm apo i përkohshëm, të kryhet korrekt sipas ligjit. Konkretisht, në pikën 1, të nenit 48, kërkohet që pozicioni ku mund të transferohet përkohësisht një nëpunës civil, duhet të jetë pozicion i shërbimit civil dhe i të njejtës kategori me pozicionin ku nëpunësi ka emërimin e përhershëm. Mosrespektimi i njërit prej kushteve të mësipërme, e bën veprimin administrativ të transferimit, të paligjshëm. Po kështu duhet thënë edhe për rëndësinë e rregullave të përcaktuara në dispozitën e nenit 50, të ligjit në fjalë. Këtu duhet të theksohet sa i rëndësishëm është akti i përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, nxjerrë nga njësia përgjegjëse, në momentin që miratohet propozimi i Komisionit të Ristrukturimit. Ky akt, bashkë me përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, shënon lindjen e disa të drejtave të nëpunësit civil që preket nga ristrukturimi, që parashikohen në pikat 7 dhe 8, të dispozitës së sipërpërmendur.

Po kështu elementë paligjshmërie janë edhe shkelja e afatit 6 mujor, gjatë dy viteve, e parashikuar në pikën 1/a të dispozitës së mësipërme që rregullon transferimin e përkohshëm, etj.

Më poshtë, pa marrë përsipër çertifikimin e rasteve të papërmendura, do të përshkruajmë disa raste konkrete, në të cilat kemi konstatuar se janë lejuar zbatime të gabuara të legjislacionit, në transferime të përkohshme ose të përhershme, në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, duke evidentuar shkeljet e kryera/lejuara, si dhe veprimet që duhen kryer për rivendosjen e ligjshmërisë, në mënyrë që në raste të ngjashme të mos përsëriten të njëjtat gabime në të ardhmen.

1. Si rast tipik (i hetuar dhe trajtuar nga Komisioneri me vendim nr. 217, datë 29.12.2020), duhet të përmendim atë të nëpunësit *****, i cili ishte nëpunës civil në pozicionin “Specialist për kontrollin arkitektonik dhe urbanistik”, që me miratimin e strukturës së fundit me urdhrin nr. 35, datë 21.01.2020 “Për miratimin e organigramës së administratës së bashkisë për vitin 2020”, të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër, iu suprimua pozicioni i punës dhe Komisioni i Ristrukturimit, me arsyetimin se nuk gjeti hapësirë për sistemimin e tij në një pozicion të barasvlefshëm në përshtatje me kualifikimin e tij, vendosi të propozojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil.

Në këtë rast, njësia përgjegjëse e bashkisë, nuk veprroi në përputhje me kërkesat e ligjit, për nxjerrjen e aktit të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil dhe zgjidhjes së pasojave të tjera që shoqërojnë këtë akt, por nëpërmjet urdhrin të Kryetarit të Bashkisë, e emëroi atë në pozicionin “Inspektor për mbojtjen e territorit”, pozicion ky, jashtë shërbimit civil.

Në përmbajtje këto veprime të njësisë përgjegjëse dhe të drejtuesit të bashkisë, nuk janë të natyrës së pavlefshmërisë absolute dhe mosmarrëveshja në thelb ka marrë zgjidhje, pasi aktualisht nëpunësi në fjalë, kryen detyrën ku është emëruar, inspektor në IMT Gjirokastër. Por, duke mos vepruar hap pas hapi, sipas procedurës së përcaktuar nga legjislacioni i shërbimit civil, këtij nëpunësi iu mohuan ato të drejta që i njohin dispozitat e pikave 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si pagesa e një dëmshpërblimi sipas vjetërsisë në shërbimin civil dhe e drejta për të konkurruar nëpërmjet lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë, për një periudhë dy vjeçare, pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil.

Në lidhje me aktin e mësipërm të Kryetarit të Bashkisë, ndonëse është nxjerrë nga një organ publik brenda kompetencave të tij, Komisioneri parashton se referenca ligjore dhe emërtimi i aktit “Për transferim të përhershëm brenda shërbimit civil” është i pasaktë, pasi nëpunësi në fjalë, pas vendimit të Komisionit të Ristrukturimit, nuk ishte më pjesë e shërbimit civil (pozicioni “Inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit” ku u emërua, nuk është pjesë e shërbimit civil). Në këto kushte, akti i emërimit duhet të kishte për referencë vetëm dispozitat e Kodit të Punës dhe ato të organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor. Për rregullimin e situatës së paligjshmërisë, Komisioneri është shprehur në vendimin nr. 217,

datë 29.12.2020, duke i lënë institucionit edhe një afat për kryerjen e veprimeve administrative.

Ndërkohë, gjatë zhvillimit të procesit të verifikimit, me anë të shkresës së regjistruar me nr. 92/3 prot, datë 25.03.2021, Komisioneri është njoftuar nga institucioni i Bashkisë Gjirokastrë, se ka rregulluar ligjshmërinë e situatës, duke plotësuar aktin e lirit të nëpunësit me të drejtat që i njejnë dispozita e pikave 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

2. ***** , me aktin nr. 6389 prot., datë 04.08.2020, është emëruar pas procedurës së konkurrimit, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit Juridik”.

Më pas, me Urdhrin nr. 118, datë 01.09.2020, të Kryetarit të Bashkisë, ai ka kaluar me transferim të përkohshëm (6 mujor) në pozicionin “Inspektor” në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, (pozicion jashtë shërbimit civil). Transferimi i nëpunësit në këtë pozicion është bërë në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil. Procedura e transferimit të përkohshëm të nëpunësit civil, është një veprim administrativ i cili rregullohet nga neni 48 “Transferimi i përkohshëm”, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe kërkesat e Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, dispozitat e Kreut I, pika 2, të cilat parashikojnë se nëpunësi civil, mund të transferohet përkohësisht në një pozicion të të njëjtës kategori, por gjithmonë brenda fushës së shërbimit civil duke ruajtur dhe kategorinë e pozicionit të punës. Në këtë rast, duke e emëruar këtë nëpunës, qoftë dhe përkohësisht, në një pozicion jashtë shërbimit civil, është prekur natyra e marrëdhënies së punësimit, nga një marrëdhënie juridike e natyrës administrative, në një marrëdhënie kontraktore, të përkohëshme. Legjislacioni i shërbimit civil, nuk lejon ndryshim në natyrën e marrëdhënies së punësimit, përveç rastit të mbylljes, apo riorganizimit të institucionit.

Në çdo rast, kur nëpunësi civil transferohet përkohësisht, në interes të institucionit, duhet të bëhet me kërkesë të institucionit, drejtorisë së interesuar apo burimeve njerëzore, veprime të cilat nuk rezultojnë të jenë kryer. Pavarësisht, se ky veprim administrativ, është kundërshtuar në gjykatë dhe aktualisht është në proces gjykimi, do të ishte e drejtë që vetë organi publik, të konstatonte kundërligjshmërinë e tij dhe të urdhëronte kthimin e nëpunësit në pozicionin ku ai ka emërimin e përhershëm “Përgjegjës i Sektorit Juridik” në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve.

3. ***** , me aktin administrativ nr. 37, datë 25.2.2014, është emëruar nëpunës civil në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e të Ardhurave Pronave Publike” dhe ka përfituar statusin e nëpunësit civil, për shkak të fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, sipas pikës 3, të nenit 67, të këtij ligji, pozicion në të cilin është konfirmuar në dt. 26.03.2018.

Aktualisht, rezulton se ky punonjës, me aktin nr. 01, datë 7.01.2020, të Kryetarit të Bashkisë është emëruar në pozicionin “Drejtor” në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve, fillimisht, me transferim të përkohshëm (3 mujor), por pas kësaj ai nuk është lëvizur më prej këtij pozicioni duke u konfirmuar si i tillë edhe në strukturën aktuale të bashkisë. Në këtë rast, duhet thënë se transferimi i përkohshëm (3 mujor) për nevoja pune, është i ligjshëm, pasi është kryer nga organi kompetent, duke respektuar edhe kategorinë e pozicionit të punës, siç kërkon pika 1, e nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Por, emërimi përfundimtar i nëpunësit ***** në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve”, është bërë pa respektuar procedurën e kërkuar nga legjislacioni i shërbimit civil. Në këtë rast nuk jemi as para një “transferimi për shkak të ristrukturimit të institucionit” dhe as përpara një “shkurtimi të pozicionit të punës”, pasi pozicioni “Drejtor në Drejtorinë e të Ardhurave Pronave Publike, lejeve dhe licensave”, është ekzistues dhe në këtë pozicion është emëruar, pa respektuar procedurën e kërkuar nga legjislacioni i shërbimit civil, shtetasja *****. Në të dy emërimet e mësipërme, nuk është respektuar, përkatësisht, procedura e konkurrimit nëpërmjet lëvizjes paralele për nëpunësin ***** dhe procedura e pranimit në shërbimin civil për nëpunësen *****.

Të dyja këto marrëdhënie punësimi, janë marrëdhënie juridike absolutisht të pavlefshme pasi janë kryer në shkelje të procedurës së kërkuar nga legjislacioni i shërbimit civil dhe si të tilla, në bazë të nenit 108, pika “a”, germat i) dhe ii) të tij, duhet të konstatohen me një akt me shkrim të Kryetarit të Bashkisë, duke urdhëruar kthimin e nëpunësit ***** në pozicionin e mëparshëm të punës dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil për punonjësen *****.

Për plotësimin e pozicioneve të mësipërme të punës, fillimisht ato duhet të shpallen pozicione të lira e pas kësaj, nëpunësi ***** mund të konkurrojë nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, për pozicionin “Drejtor në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve”, kurse për pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e të Ardhurave Pronave Publike, lejeve dhe licensave”, konkurrimi duhet të fillojë me shpalljen e konkurrimit për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë (nëse tregon interes ndonjë nga nëpunësit ekzistues të bashkisë) dhe vetëm pas kësaj mund të vijojë konkurrimi për pranim nga jashtë shërbimit civil.

4. ***** me aktin administrativ nr. 5221 prot., dt. 30.8.2016, është emëruar me konkurrim nëpunës civil në pozicionin “Specialist prokurimesh”. Nga këqyrja e dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se ky punonjës, në vitin 2020 i është nënshtruar një serie lëvizjesh kaotike, në detyra të ndryshme, duke mos përfillur rregullat e legjislacionit të shërbimit civil.

Konkretisht, me urdhrin nr. 03, datë 07.01.2020, pa respektuar rregullin e ruajtjes së kategorisë në rastet e transferimeve të përkohëshme, me arsyetimin për nevojat e institucionit, ka kaluar në pozicionin “Përgjegjës i Njësisë të Prokurimeve”. Ky akt është i kundraligjshëm pasi vjen në kundërshtim me kërkesën kryesore të nenit 48, të ligjit nr

152/2013, për ruajtjen e kategorisë së pozicionit të punës. Me të njëjtin akt, është kryer edhe një veprim tjetër i kundraligjshëm, pasi ish përgjegjësi i Njesisë së Prokurimeve, nëpunësi *****, është transferuar në mënyrë të përkohëshme, në pozicionin “*Specialist prokurimesh*” pozicion ky i një kategorie më të ulët se pozicioni ku ai ka emërimin e përhershëm.

Nuk del e qartë, se për këtë të fundit kemi të bëjmë me një masë ndëshkimore, apo se nga ana e njesisë së burimeve njerëzore dhe drejtuesit të institucionit nuk është kuptuar si duhet instituti i transferimeve të përkohshme.

Nënvizojmë në këtë rast, që nëse nëpunësi ***** , ka kryer ndonjë shkelje disiplinore apo ka patur mosrealizime të detyrave dhe objektivave të punës, duhej të ishte kërkuar fillimi i ecurisë disiplinore dhe çështja duhej të zgjidhej ose nga eprori direkt ose çështja ti kalonte për kompetencë Komisionit Disiplinor. Theksojmë gjithashtu, që ligji nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar (*neni 58 i tij*) nuk e njeh “*zbritjen në detyrë*” si një nga llojet e masave disiplinore.

Në këtë pozicion, nëpunësi ***** , ka punuar për 7 muaj, deri kur me aktin nr.100 datë 28.07.2020, të Kryetarit të Bashkisë, është kthyer në pozicionin e tij “*Specialist prokurimesh*”.

Pas një muaji, me aktin nr. 509, dt. 25.08.2020, të Kryetarit të Bashkisë, është transferuar përsëri (*pa përcaktuar transferim i përkohshëm apo i përhershëm*) në pozicionin “*Inspektor Vjelje Taksash për Njësitë Administrative dhe ndjekjen e debitorëve*”, në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licensave dhe afro 15 ditë më pas, me urdhrin nr.128, datë 11.09.2020, ka kaluar me transferim të përhershëm, në pozicionin “*Specialist kontabilitet finance-iventarizim*”, në Bashkinë Gjirokastrë.

Ashtu si shihet, kemi një seri lëvizjesh të këtij nëpunësi, pa respektuar të drejtat e tij si nëpunës civil dhe pa përfillur vullnetin e tij. Akti i fundit nr. 128, datë 11.09.2020, për transferimin e përhershëm të nëpunësit ***** , në pozicionin “*Specialist kontabilitet financë-iventarizim*” është një akt absolutisht i pavlefshëm pasi në kryerjen e kësaj lëvizje paralele, nuk është respektuar procedura e kërkuar nga dispozita e nenit 25, e ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe vendimi nr. 243, datë 18.03.2015, i Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”. Mosrespektimi i procedurës, sipas nenit 108, pika “a”, germa ii) të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*” bën që akti në fjalë është akt absolutisht i pavlefshëm dhe si i tillë në bazë të nenit 110, pika 1, e ligjit të sipërpërmendur, nuk mund të sjellë anjë pasojë juridike.

Për rivendosjen e ligjshmërisë në këtë rast, në bazë të nenit 108 dhe 110, të ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*” organi publik (*në këtë rast Kryetari i Bashkisë*),

duhet që me një akt të ri me shkrim, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 128, dt. 11.09.2020, dhe të urdhërojë kthimin e nëpunësit ***** në pozicionin e punës ku ai ka emërimin e rregullt “*Specialist prokurimesh*”.

Në rast se, pozicioni i punës “*Specialist kontabilitet finance-iventarizim*” shpallet pozicion i lirë dhe nëpunësi ***** shfaq interes, mund të konkurrojë nëpërmjet procedurës për lëvizje paralele, ose pozicioni duhet të plotësohet nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil. Nëse pozicioni i punës do të plotësohet nga ky nëpunës, pas kryerjes së procedurës për lëvizje paralele, e njëjta procedurë do të zbatohet edhe për plotësimin e pozicionit “*Specialist prokurimesh*” në Drejtorinë Juridike dhe të Prokurimeve Publike, që më parë e mbante ky nëpunës.

5. ***** me aktin nr. 285 prot., datë 03.09.2018, është emëruar me konkurrim nëpunës civil në pozicionin “*Specialist mjedisi*” në Sektorin e Shërbimeve Urbane.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se kjo punonjëse, me aktin nr. 364, datë 13.09.2019, të Kryetarit të Bashkisë është emëruar me transferim të përkohshëm (3 mujor), në pozicionin “*Kryeinspektor*” në INU. Konstatohet se transferimi i nëpunëses në pozicionin aktual, është bërë në kundërshtim me procedurat e kërkuara nga ligji. Procedura e transferimit të përkohshëm të nëpunësit civil, është një veprim administrativ i cili rregullohet nga neni 48 “*Transferimi i përkohshëm*”, i ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe kërkesat e Vendimit nr. 125, datë 17.02.20116, të Këshillit të Ministrave “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, dispozitat e Kreut I, pika 2, të cilat parashikojnë transferimin përkohshëm të nëpunësi civil, në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. Në asnjë rast ligji nuk parashikon ndryshim në natyrën e marrëdhënies së punës, përveç rastit të mbylljes, apo riorganizimit të institucionit. Në çdo rast, nëpunësi civil mund të transferohet në interes të institucionit, me kërkesë të institucionit, drejtorisë së interesuar apo burimeve njerëzore.

Në analizë të akteve si më sipër, theksojmë se, “*Kthimi në vendin e punës bëhet nga njësia përgjegjëse pas mbarimit të afateve të prashikuara në vendimin e njësisë përgjegjëse dhe jo më vonë se afatet e parashikuara në pikën 2 të vendimit si më sipër*” (Kreut I, pika 12).

Në këto kushte, transferimet e përkohshme të kryera si më sipër, përderisa nuk kanë një akt për miratimin nga ana e njësisë përgjegjëse, si dhe janë në tejkalim të afateve ligjore të përcaktuara, konsiderohen se nuk janë realizuar dhe nëpunësit duhet të kthehen në pozicionet e tyre të punës ku ata kanë emërimin.

Së treti, konstatohet se në disa procedura konkurrimi, të zhvilluara më parë, ka dokumenta të prodhuara që paraqesin mangësi të dukshme, me karakter formal e material, në kundërshtim me kërkesat e dispozitave të neneve 98, 99, 100 etj., të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”. Kështu:

- a) Në kryerjen e procedurës së konkurrimit për plotësimin e pozicionit të nivelit të mesëm drejtues “*Drejtor i Shërbimeve Sociale dhe Kulturore*”, në Bashkinë Gjirokastrë, në përfundim të të cilës është emëruar nëpunësja *****, rezulton që aktet e nxjerra për zhvillimin e procedurës vijnë në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të procedurës së konkurrimit të pretenduar, janë me mangësi të ndryshme.

Konstatohet se urdhri “*Për krijimin e Komitetit të Përhershëm të Pranimit*” është pa numër protokolli, pa datë dhe i panënshkruar nga drejtuesi i institucionit; po kështu, “*Lista e pyetjeve të testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar*” është pa numër dhe datë, si dhe e pafirmosur nga të gjithë anëtarët e KPP. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për “*Raportin përfundimtar*” të procedurës së pranimit në shërbimin civil për pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale dhe Kulturore*”, në Bashkinë Gjirokastrë, i cili rezulton i paregjistruar në aktet e bashkisë dhe pa firmat e të gjithë anëtarëve. Sipas këtij raporti, konkurrenti fitues ka qenë ***** e për këtë, me aktin nr. 21, datë 17.01.2019 “*Për emërim në detyrë*”, kryetari i Bashkisë Gjirokastrë ka emëruar nëpunësen në fjalë në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale dhe Kulturore*”.

Aktet e mësipërme janë akte administrative, forma e të cilave përcaktohet nga ligji nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, në pikat 2, 3, etj., të nenit 99, theksohet: “*...Akti administrativ përmban: a/iii) datën e miratimit...; Akti administrativ i shkruar në letër përmban nënshkrimin, emrin dhe mbiemrin e shkruar të nëpunësit përgjegjës, apo të Kryetarit...*”, kërkesa këto që aktet e mësipërme nuk i plotësojnë.

- b) E njëjta gjë mund të thuhet edhe për procedurën e konkurrimit, të kandidatës *****, për plotësimin e pozicionit “*Specialist i Statistikës*”, ku konstatohen mangësi të njëjta si në rastin e mësipërm.

Në përfundim të kësaj procedure me aktin nr. 220, datë 21.06.2018 “*Për emërim në detyrë*”, Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, ka emëruar konkurrenten ***** në pozicionin “*Specialist i Statistikës*”, në Sektorin e Projekteve Strategjike dhe Statistikave. Në vijim, me aktin e transferimit nr. 3, datë 27.01.2020, të Kryetarit të Bashkisë, nëpunësja në fjalë transferohet për shkak të ristrukturimit, në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Koordinimit të Integritet Europian*”.

Nga këqyrja e akteve të ndryshme që janë përpiluar në faza të ndryshme të procedurës administrative të kryer, rezulton se ato nuk janë të plotësuar në gjithë ekstremitetet e nevojshme. Konkretisht, në disa akte të Komitetit të Pranimit, si vendimi për rezultatin përfundimtar të procedurës së pranimit në shërbimin civil, nuk janë shënuar numri i protokollit dhe data e vendimit si dhe nuk është nënshkruar nga gjithë anëtarët e Komitetit të

Pranimit. E njëjta gjë vërehet tek procesverbali i prezencës së kandidatës së paraqitur në konkurrim dhe tek lista e pyetjeve të testit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Këto mangësi janë elementë parregullsie dhe paligjshmërie të procedurës administrative të kryer, të cilat të çojnë në përfundimin se mund të jemi para veprimeve administrative fiktive, me qëllim favorizimi të personit të shpallur fitues i konkurrimit, ose përpara moskryerjes si duhet të detyrës nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit dhe anëtarëve të Komitetit të Pranimit, veprime këto që vënë në diskutim krejt veprimin administrativ të kryer.

Duke nënvizuar edhe një herë përgjegjësinë e njësisë së burimeve njerëzore për gjithë parregullsitë e lejuara apo kryer, në rastet që u shqyrtuan në mënyrë analitike më sipër, lind e nevojshme që në frymën e analizës së atyre rasteve, duhet të shqyrtohen edhe raste të tjera të ngjashme. Në përfundim të analizës, nisur nga natyra e parregullsive që do të evidentohen në të ardhmen, duhet të vepohet menjëherë për marrjen e masave konkrete për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë.

Në të njëjtën kohë, duhet të tregohet kujdesi i duhur që aktet të kenë referencën e duhur ligjore sipas rastit, duke evituar kopjimin e akteve të mëparshme të ngjashme. Arrijmë në këtë konkluzion, pasi në shumë prej akteve të shpalljes së konkurrimit, të ngritjes së Komitetit të Përhershëm të Pranimit, të përzgjedhjes së kandidatit pas paraseleksionimit, të emërimit, etj., vërehet se referenca është tek akte të Këshillit të Ministrave të cilat janë shfuqizuar. Kjo do të thotë se përdoren modele të vjetra të cilat janë të memorizuara në kompjuter, të cilat merren me *copy-paste* dhe nuk bëhen përpjekje për azhornimin e akteve me legjislacionin që është aktualisht në fuqi.

Nisur nga pasaktësitë dhe parregullsitë e konstatuara, në rastet e përmendura më sipër, lind domosdoshmëria që para arritjes në përfundimin, nesë këta elementë paligjshmërie e bëjnë të cënueshëm në përmbajtje procesin administrativ përkatës, të kryhen disa veprime plotësuese. Këtu është fjala për *ngritjen e një grupi pune, me përbërje të paktën tre vetë*, i cili të marrë edhe një herë në shqyrtim dokumentacionin e rasteve të ekstratuara në material, për të verifikuar dhe rivlerësuar ato shkelje të konstatuara dhe në përfundim të arrihet në një konkluzion të saktë.

Kjo do të kërkojë shqyrtimin e rregullshmërisë së akteve të përmendura, si nga pikpamja formale ashtu edhe nga pikpamja e përmbajtjes së tyre. Për këtë, do të jetë i nevojshëm një kontroll më i hollësishëm nëpër regjistrat e protokollit, për të parë nëse janë bërë shënimet përkatëse të akteve të nxjerra, por që për pakujdesinë e ish nëpunësve të njësisë së burimeve njerëzore, nuk janë pasqyruar saktë në dokumentacionin e prodhuar në kryerjen e këtyre konkurrenive dhe në dosjet personale të nëpunësve.

Për të rregulluar këtë situatë, mund të jetë e nevojshme të bashkëpunohet edhe me nëpunësit që preken nga ky proces, në mënyrë që ata të kenë mundësi të paraqesin pretendimet e tyre, apo dokumentacion që mund të disponojnë personalisht dhe të mos dëmtohen padrejtësisht. Vetëm pas kryerjes së një verifikimi të kujdesshëm e të plotë nga ana e këtij grupi, të dokumentacionit të duhur, të nxirren konkluzione sa më objektive.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 113, i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA

1. Organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, të konstatojë paligjshmërinë e aktit nr. 118, datë 01.09.2020, të transferimit të përkohshëm, në pozicionin “Inspektor” në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit (IMT), për nëpunësin ***** dhe të urdhërojë kthimin e nëpunësit në pozicionin ku ai ka emërimin e përhershëm “Përgjegjës i Sektorit Juridik” në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve.
2. Të konstatohet pavlefshmëria absolute e akteve administrative: vendimi nr. 1, datë 7.01.2020, i Kryetarit të Bashkisë, për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “Drejtor” në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve dhe vendimi nr. 2 prot., datë 7.01.2020, i Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, për emërimin e nëpunëses ***** në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e të Ardhurave Pronave Publike, lejeve dhe licensave”, në bazë të nenit 108, pika “a”, germa i) dhe ii) të ligjit; Kryetari i Bashkisë, të urdhërojë kthimin e nëpunësit ***** në pozicionin e mëparshëm të punës dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil për punonjësen *****.

Për plotësimin e pozicioneve të mësipërme të punës, fillimisht ato duhet të shpallen pozicione të lira e pas kësaj, nëpunësi *****, nëse shpreh interes, mund të konkurrojë nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, për pozicionin “Drejtor në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve”, kurse për pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e të Ardhurave Pronave Publike, lejeve dhe licensave”, konkurrimi duhet të fillojë nga e para, me shpalljen e konkurrimit për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë (nëse tregon interes ndonjë nga nëpunësit ekzistues të bashkisë) dhe vetëm pas kësaj mund të vijojë konkurrimi për praninë nga jashtë shërbimit civil.

3. Në bazë të nenit 108 dhe 110, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH” organi publik (në këtë rast Kryetari i Bashkisë), duhet që me një akt të ri me shkrim, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 128, datë 11.09.2020, për transferimin e nëpunësit *****, në pozicionin “Specialist kontabilitet financë-iventarizim” dhe të urdhërojë kthimin e nëpunësit në pozicionin e punës, ku ai ka emërimin e rregullt “Specialist prokurimesh”.
4. Të anulohet akti nr. 364, datë 13.09.2019, të Kryetarit të Bashkisë, për emërimin e nëpunëses *****, në pozicionin “Kryeinspektor”, në INU dhe nëpunësja të kthehet në pozicionin e saj të punës ku ajo ka emërimin e rregullt.
5. Njësia përgjegjëse të ndjekë procesin e ngritjes së grupit të punës dhe veprimtarinë e tij, sipas udhëzimeve të dhëna në pjesën e fundit të pjesës arsyetuese të këtij vendimi, deri në përmbylljen e proceseve si më sipër dhe në përfundim të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Për kryerjen e veprimeve administrative të mësipërme, lihet afat 15 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim.

Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha